



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

Durrës 08.04.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si mëposhtë vijon:

- **Cili është bilanci zyrtar i dëmeve nga përmytja e 6 janarit në territorin e Bashkisë Durrës, si në vlerë totale ashtu edhe në numër banesash dhe biznesesh të prekura, dhe a është përfunduar plotësisht procesi i verifikimit në terren?**

Sa I perket pikes 1, ju informojmë se është ngritur komisioni i ekspertëve për vlerësimin e dëmeve të shkaktuar nga përmytja si pasojë e reshjeve të datës 06.01.2026 nga Titullari i Institucionit, ku të gjithë Njësitë Administrative po dorëzojnë praktikat e secilit banor të përmytur shoqëruar me dokumentacionin përkatës. I gjithë dokumentacioni do të vlerësohet bazuar në legjislacionin në fuqi dhe lista me përfituesit do të shpallet me Këshill Bashkiak.

Në lidhje me bizneset, ju informojmë se, referuar VKM-së nr. 329/2012 në kushtet e mosshpalljes së gjendjes së emergjencës civile nuk merren në konsideratë.

- **A është miratuar një fond për dëmshpërblimin e familjeve dhe bizneseve të prekura dhe, nëse po, sa është vlera e tij, sapërfitues kanë marrë deri tani kompensim dhe sa është masa mesatare e dëmshpërblimit?**

Bashkia Durrës, aktualisht është në fazën e pritjes së fondit të kushtëzuar I destinuar për këtë proces. Nisur nga numri I lartë I te prekurve, trajtimi financiar do ti kaloj Agjensise Kombetare te Mbrojtes Civile.

- **Në rast se jo të gjithë të dëmtuarit janë kompensuar, kur parashikohet përfundimi i këtij procesi dhe sa raste janë ende në pritje?**

Trajtimi financiar, do te trajtohet me perparesi sipas mundesise se fondit te kushtezuar.

- **A ka pasur ankesa nga qytetarët apo bizneset lidhur me vlerësimin e dëmeve apo shpërndarjen e kompensimeve dhe si janë trajtuar ato?**

Aktualisht jemi në procesin e vlerësimit dhe ende nuk ka përfunduar vlerësimi financiar. Duhet theksuar se jemi përpara situatës së ndihmës financiare e cila do të lëvrohet në vijim nga buxheti institucioneve shtetërore dhe jo shkaktimin të dëmit nga instancat shtetërore.

- **Çfarë masash janë ndërmarrë pas ngjarjes për rehabilitimin e zonave të dëmtuara dhe për përmirësimin e sistemit të kullimit në zonat më problematike ?**

Masat e ndërmarra për rehabilitimin e zonave të dëmtuara dhe përmirësimin e sistemit të kullimit janë realizuar në përputhje me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligjin nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”.

Në zbatim të këtyre akteve, janë ndërmarrë ndërhyrje për pastrimin e zonave të prekura dhe përmirësimin e funksionimit të rrjetit të kullimit, veçanërisht në zonat më problematike. Konkretisht, është kryer pastrimi dhe largimi i mbetjeve inerte, si dhe rikthimi në gjendjen e mëparshme i sipërfaqeve të dëmtuara. Paralelisht, janë realizuar ndërhyrje në rrjetin e kullimit, duke përfshirë pastrimin e kanaleve ekzistuese, zhbllokimin e pusetave dhe riparimin e segmenteve të amortizuara. Nga ana e SHRUKD sh.a janë pastruar në mënyrë sistematike pusetat e ujërave të ndotura.

Gjithashtu, janë evidentuar pikat kritike, për të cilat janë planifikuar ndërhyrje të mëtejshme me qëllim zgjerimin dhe përmirësimin e kapacitetit të sistemit të kullimit, në funksion të parandalimit të përsëritjes së situatave të ngjashme në të ardhmen.

Autoritetet përkatëse vijojnë monitorimin e situatës në terren dhe janë në proces të hartimit dhe zbatimit të masave afatgjata për rritjen e qëndrueshmërisë së infrastrukturës në këto zona.